



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## ***Raporti i punës 2023***

### ***Drejtoria e Arsimit***

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të mësimdhënies dhe mësim nxënies në komunën e Podujevës janë proceduar për vitin 2023 këto projekte:

- Furnizimi me kabinete muzikore, për këtë projekt janë të planifikuar 8,730.00 euro.
- Furnizimi me rekuizita sportive, është nënshkruar kontrata për këtë projekt që kap vlerën 15,279 euro.
- Në bashkëfinancim me IOM për fushën e edukimit fillor janë pajisur me kabinete në shkollat Orllan dhe Sfeçël.
- Furnizimi me inventar për shkolla ( dollapë personal për nxënës dhe inventar, vlera 140.000 euro
- Furnizimi me kabinete të gjeografisë, historisë, matematikës, është nënshkruar kontrata ku vlera e saj është 48,681 euro .
- Instalimi i kamerave nëpër shkolla ku është nënshkruar kontrata, ne si DKA kemi planifikuar ti vendosim kamerat në objekte shkollore dhe të intervenojmë në disa objekte ku ka kamera ekzistuese ku do të përfshihen 9 objekte shkollore.
- Furnizimi për inventar në çerdhe, ne vlerë financiare 54, 729,58 euro.
- Kemi inauguruar Qendrën e parë të Karrierës në Podujevë

Në këtë qendër të rinjtë tanë do të mbajnë trajnime dhe do të këshillohen nga trajnerë kompetentë duke i orientuar ata për tregun e punës dhe mundësitë që ofrohen në sektorë të ndryshëm për të zhvilluar një karrierë të suksesshme. Qëllimi i themelimit të Qendrës së Karrierës është identifikimi i talenteve dhe potencialeve si dhe zhvillimi i tyre.

Projekti për Qendrën e Karrierës u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe përfaqësuesit e Projektit Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE).

- Kemi pranuar një donacion të vlefshëm për nxënësit e IAAP "Fan.S.Noli" me pajisje të zdrukthëtarisë nga bashkëpunimi që kemi pasur me qytetin e Bursës.
- Kemi ndarë bursa për 265 student në vlerë prej 92,750 euro

#### **Kapitalet:**

- Kemi inauguruar masat e efijencës së energjisë - projekt i realizuar në bashkëfinancim mes Qeverisë së Kosovës, BE-së dhe Bankës Botërore në vlerë 730,000 euro.
- Është intervenuar në dhjetëra shkolla si rregullimi i infrastrukturës shkollore
- Gjatë këtij viti janë kryer punimet në ndërtimin e objektit shkollor në Obranqë dhe jemi në fazën finale të përfundimit të punimeve të objektit shkollor në Dumosh, si dhe sallave sportive në SHFMU " Enver Maloku " Podujevë dhe SHFMU " Naim Frashëri " Podujevë, njëkohësisht janë duke u zhvilluar punimet në ndërtimin e SHFMU " Ilir Konusheci " Llugë, dhe në objektin e ri të çerdhes për fëmijë në qytetin e Podujevës. Vlera financiare e këtyre projekteve është mbi 2 milion.
- Ndërtimi i ashensorit, pjerrinave dhe renovimi i banjave për nxënësit me nevoja të veçanta në SHFMU " Shaban Shala" në Podujevë të financuar nga Bashkimi Evropian që kap vlerën 150,000 euro.

- Renovimi i tërësishëm i brendshëm i pjesës së vjetër të objektit të shkollës “Shaban Shala” në Podujevë të financuar nga Bashkimi Evropian që kap vlerën 350,000 euro.

- Realizimi i projektit “Yeni” bashkëfinancim mes Komunës së Podujevës dhe Caritasit Zvicëran për dy shkollat e mesme “Aleksander Xhuvani” dhe “Fan S. Noli” në Podujevë që kap vlerën 9,000 euro .

Përrurimi i dy çerdheve të reja në fshatrat Lluzhan dhe Sfeçël dhe vënia e gurthemelit për ndërtimin e çerdheve në Qytet dhe fshatin Batllavë.

Furnizim me inventar për pesë klasat përgatitore në pesë shkolla në bashkëfinancim me Caritasin zvicerian.

### **Aktivitete:**

- Me pjesëmarrjen e mbi 1000 nxënësve të shkollave të mesme, shoqatën e peshkatarëve "Llapi", OJQ lokale dhe qytetarë të komunitetit të Orllanit është zhvilluar aksioni për pastrimin e të gjithë hapësirës përreth liqenit të Batllavës në gjatësi rreth 8 km.

- Bashkëpunime me OJQ vendore punëtori e përbashkët ku qëllimi i kësaj punëtorie është krijimi i një agjende të qytetit ku do të përmirësohen hapësirat publike, dhe në fokus të saj ka krijimin e një qyteti më të mirë për fëmijët dhe të rinjtë duke zhvilluar një plan gjithëpërfshirës për të adresuar sfidat me të cilat ata përballen në përditshmëri.